



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë,

Tel/Fax 04 2226814; 22268142

Nr. 587/6 Prot.

Tiranë më 28.10.2016

**V E N D I M**

**Nr. 108, datë 28.10.2016**

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ,  
filluar me Urdhërin e verifikimit nr. 587/1 prot., datë 30.09.2016**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neneve 77 e vijues të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit nr. 234 prot., datë 18.10.2016, dhe mendimit të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me disa parregullsi të konstatuara në kryerjen e ecurive disiplinore ndaj një nëpunësi civil të Ministrisë së Mbrojtjes,

**V ë r e j s e :**

Bazuar në urdhërin e verifikimit nr. 587/1 prot., datë 30.09.2016, "Për verifikimin e informacionit të ardhur nga një nëpunës civil i Ministrisë së Mbrojtjes, në lidhje me parregullsi të pretenduara gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore", ka filluar hetimi administrativ lidhur me procedurat e ndjekura nga Komisioni i Disiplinës pranë Ministrisë së Mbrojtjes, për dy ecuri disiplinore ndaj nëpunësit civil \*\*\*\*\*.

Nga përmbajtja e dokumentacionit të mbledhur në kuadër të këtij hetimi administrativ, rezulton se shkak për fillimin e kësaj procedure është bërë një ankesë e paraqitur prej nëpunësit \*\*\*\*\* , protokolluar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 587 prot., datë

22.09.2016, përmes së cilës pretendohet se ndaj tij, në shkelje flagrante të ligjit, janë marrë dy masa disiplinore, ku së fundi është vendosur dhe largimi i tij nga shërbimi civil. Në kërkesë është pretenduar se nga ana e Komisionit Disiplinor, nuk janë respektuar kërkesat e ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe procedurat e ndjekura janë jo-profesionale, keqdashëse dhe tendencioze.

Për kryerjen e këtij hetimi administrativ, fillimisht, me shkresën nr. 587/2,3, dt 30.09.2016, janë njoftuar për fillimin e verifikimit të informacionit, Ministria e Mbrojtjes dhe Departamenti i Administratës Publike, dhe përmes këtij njoftimi u kërkua nga këto institucione, vënia në dispozicion e gjithë akteve administrative që materializojnë zhvillimin e ecurive disiplinore në fjalë, që nga momenti i konstatimit të shkeljes disiplinore, vënies në dijeni me shkrim të personit që pretendohet se ka kryer shkeljen, deri në dhënien e vendimit përfundimtar prej organit disiplinor.

Nga aktet administrative të mbledhura gjatë verifikimit të rastit, rezulton se, kërkuesi \*\*\*\*\* , prej muajit nëntor 2001 ka kryer funksionin e “*përgjegjës të çështjeve gjyqësore*” pranë DPSHM në Ministrinë e Mbrojtjes.

Fillimisht ndaj tij, me kërkesë të eprorit direkt nr. 875, datë 15.03.2016, u iniciua një procedurë disiplinore, e cila përfundoi me vendimin nr. 1019/5, datë 03.05.2016, të Komisionit Disiplinor, pranë Ministrisë së Mbrojtjes, përmes të cilit u vendosur dhënia e masës disiplinore, “*mbajtja e 1/3 të pagës së plotë për një periudhë tre mujore*”. Rezulton se, kjo masë disiplinore, është ankimuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 1019/5, datë 03.05.2016, të Komisionit Disiplinor, si të paligjshëm.

Më tej, me Vendimin nr. 3530, datë 06.07.2016, të kësaj gjykate, është vendosur pranimi i padisë; shfuqizimi i aktit administrativ objekt i këtij gjykimi, dhe kthimi i pagës së mbajtur për shkak të fillimit të efekteve të masës disiplinore.

Ndërkohë, ende pa u shprehur Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, lidhur me ecurinë disiplinore që analizuam më sipër, ka filluar një ecuri tjetër disiplinore, nisur me kërkesën e eprorit direkt, nr. 3440, datë 24.05.2016, e cila është pjesë e praktikës së administruar gjatë këtij hetimit. Në lidhje me këtë ecuri disiplinore, me Vendimin nr. 3440/13, datë 20.06.2016, të Komisionit Disiplinor, pranë Ministrisë së Mbrojtjes, është vendosur dhënia e masës disiplinore, “*largim nga shërbimi civil*”, ndaj nëpunësit civil \*\*\*\*\* , përgjegjës sektori në sektorin e çështjeve gjyqësore në Drejtorinë e legjislacionit, në DPSHM, në Ministrinë e Mbrojtjes.

Gjatë verifikimit të kryer me këtë rast, rezulton se edhe ndaj këtij vendimi, nëpunësi civil i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me kërkesëpadi, duke kërkuar

shfuqizimin e vendimit nr. 3440/13, datë 20.06.2016, të KD dhe kthimin e tij në pozicionin e mëparshëm të punës, si dhe pagimin e pagës për periudhën e mbetur padrejtësisht pa punë. Ky fakt provohet nga vërtetimi i datës 04.10.2016, lëshuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

Në këto rrethana, konkludoj se, referuar nenit 36 të Kodit të Procedurës Civile, i cili sanksionon parimin e moslejimit të shqyrtimit nga institucionet e tjera, të çështjeve që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, duhet të vendoset përfundimi i procedimit.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Të deklarojë përfundimin e hetimit administrativ, të nisur me urdhërin e verifikimit nr. 587/1 prot., datë 30.09.2016, “Për verifikimin e informacionit të ardhur nga një nëpunës civil i Ministrisë së Mbrojtjes, në lidhje me parregullsi të pretenduara gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore”.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Ministria e Mbrojtjes, Departamenti i Administratës Publike dhe kërkuesi \*\*\*\*\*.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**